



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 11.12.2018, ora 13:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës :**

Shqyrtim i projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar ”.

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Paulin Sterkaj, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Vullnet Sinaj, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Aqif Rakipi, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Spartak Braho dhe Klodiana Spahiu.

**Mungojnë:**

Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslim Murrizi, Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Braimllari dhe Xhemal Gjunksi.

**Të ftuar:**

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Julian Hodaj – zëvendësministër i Punëve të Brendshme

Edis Ibrahim – Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi – Përgjegjëse e sektorit në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit

Stefan Cipa – Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Erion Semani – Drejtor i Çështjeve Ligjore, Shoqërore dhe Shëndetësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

## HAPET MBLEDHJA

**Ermonela Felaj** – Përshëndetje!

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar shqyrtimin projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar". Është një ndryshim i propozuar nga Ministria e Drejtësisë, është një nen që propozohet t'i shtohet ligjit në fjalë, të cilin do e shpjegojë më qartë ministrja e Drejtësisë, e ftuar për të prezantuar këtë projektligj. Komisioni i Sigurisë është komision për dhënie mendimi në këtë rast, pasi komisioni përgjegjës është Komisioni i Ligjeve. Relator nga komisioni ynë është zoti Pjerin Ndreu.

Ndërkohë të ftuar për të prezantuar këtë projektligj kemi ministren e Drejtësisë, zonjën Gjonaj.

Faleminderit, zonja Gjonaj!

Zotin Julian Hodaj, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, zotin Stefan Cipa, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, zotin Edis Ibrahim, këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë, zonjën Eljona Bylykbashi, përgjegjëse e Sektorit në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit dhe zotin Erion Semani, drejtor i Çështjeve Ligjore, Shoqërore dhe Shëndetësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Do t'ia kaloj menjëherë fjalën zonjës ministre për prezantimin e ndryshimit që ju propozoni në këtë ligj.

**Etilda Gjonaj** - Faleminderit, zonja kryetare e komisionit për ftesën!

Të nderuar anëtarë të komisionit!

Më lejoni që të përmend përpara se të futem në detaje të propozimit të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me nenin 13, paragrafi i parë të ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", se lufta pa kompromis kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Njëkohësisht është dhe një nga detyrimet kryesore që rrjedhin nga procesi i integritetit në BE. Kjo luftë është ashpërsuar më tej dhe masat e qeverisë janë bërë më efikase gjatë vitit të fundit, sidomos edhe me një sërë iniciativash siç është edhe operacioni "Forca e ligjit". Rezultatet janë konkrete. Një numër i konsiderueshëm grupesh kriminale është goditur dhe pjesëtarët e tyre sot ndodhen pas hekurave të burgjeve në pritje të gjyqimit, por sa më forta bëhen masat tona dhe sa më

të dukshme janë rezultatet aq më i sofistikuar përpiket që të bëhet krimi për të vijuar aktivitetin e paligjshëm.

Nga puna operative e strukturave të sigurisë në burgje, por edhe nga strukturat e Policisë së Shtetit është konstatuar se elementët kriminalë ndonëse të izoluar në burgje kanë tendencën të vijojnë të ruajnë lidhjen me bashkëpunëtorët të organizatave të tyre kriminale apo të organizatave të tjera, edhe duke u ndodhur brenda sistemit të burgjeve, edhe duke mbajtur këto lidhje me ata që janë jashtë, duke konsideruar kështu që mund të jetë edhe një rrezik për vijueshmërinë e aktivitetit kriminal nga ana e tyre. Në këtë kontekst të forcimit të masave të luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar dhe veçanërisht të izolimit sa më mirë të të gjithë elementëve kriminalë, të cilët konsiderohen të rrezikshëm, tashmë janë në burgjet e vendit, vjen pikërisht ky propozim për ndryshimin e nenit 13 në këtë projektligj.

Qëllimi i projektligjit apo i ndryshimeve, propozimit të ri është rritja e masave të sigurisë dhe kufizimi i disa prej të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve për raste të veçanta që lidhen me krimin e organizuar, duke iu nënshtruar një regjimi të posaçëm brenda sistemit të sigurisë së lartë. Masat e ndërmarra në kuadër të zbatimit të këtij regjimi janë të ngjashme me masat e parashikuara në të ashtuquajturën modelin italian “41 bis”, i cili ka kaluar disa herë si iniciativë edhe nga legjislacioni italian, edhe në shqyrtimin e jurisprudencës të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku është parë nëse ky parashikim, ky kufizim i të drejtave për këtë kategori të elementëve kriminalë përbën një shkelje të nene, të të drejtave konventore apo jo. Sipas kësaj jurisprudence, këto masa janë të nevojshme, janë konsideruar të nevojshme në rastet kur cenohet rendi apo siguria në institucion, si edhe për të mbajtur në kontroll elementët kriminalë, të rrezikshëm, të cilët janë konsideruar për një sërë veprash penale, ashtu siç ka ardhur edhe në propozimin tonë për disa dispozita të përcaktuara. Në të gjitha rastet kur këto përdoren abuzivisht dhe në mënyrë arbitrare, atëherë mund të përbëjnë një motiv për t’iu drejtuar Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

I jemi referuar modelit italian, sepse gjykojmë se ka dhënë rezultate konkrete dhe është i mundshëm të aplikohet edhe në Shqipëri. Nga një bashkëpunim tepër i ngushtë që kemi si Ministri e Drejtësisë, së bashku me organet ligjzbatuese me prokurorinë antimafia italiane ata kanë vlerësuar jashtëzakonisht përfshirjen e këtij parashikimi të ri ligjor dhe zbatimin e këtij regjimi të kufizuar brenda sigurisë së lartë, gjithmonë në luftën e bashkërenduar për luftën kundër krimit të organizuar.

Mënyra e zbatimit të këtyre masave në realitetin shqiptar është paksa më ndryshe nga zbatimi i praktikës italiane, por theksoj se zbatimi i këtyre masave, është studiuar edhe nga drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë se janë në përputhje me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas këtyre orientimeve kufizime të tilla të të drejtave duhet të ndërmerren vetëm për situata emergjente, vetëm për dispozita të parashikuara qartë ashtu siç janë parashikuar edhe në propozimin e ardhur te ju dhe për një kohëzgjatje të përcaktuar. Pra, nuk mund të jenë pa limit si kufizime të të drejtave për këtë kategori elementësh kriminalë.

Në kushtet e realitetit shqiptar nisur edhe nga detyrat që BE-ja i ka ngarkuar Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar, ky fenomen aktualisht përbën një situatë emergjente. Mund të prisnim mjaft mirë, ashtu siç e kam deklaruar edhe më herët në komisionin tuaj që të sillnim paketën e ligjeve me të cilat grupi i punës në Ministrinë e Drejtësisë po punon për sa i përket sistemit penitenciar, ekzekutimin e vendimeve penale dhe shërbimit të provës, por duke e parë si situatë emergjente ky propozim vjen tani me qëllim që të fillojë zbatimin e menjëherë dhe lufta kundër krimit të organizuar të jetë një cikël i mbyllur, duke përfshirë që nga Policia, organet e tjera ligjzbatuese dhe për ekzekutimin e vendimeve penale. Për këtë arsye edhe në parashikimin e propozuar, që në fillim thuhet se nëse një person do të arrestohet ose do të gjykohet për veprat penale të propozuara në nenin 13, paragrafi i parë, ai duhet të vendoset menjëherë në një regjim të posaçëm me kufizim të të drejtave me qëllim parandalimin e kontakteve me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizatat e tjera aleate, konfliktet e mundshme me elementë të organizatave kundërshtarë dhe ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë që u përkasin të njëjtës organizatë apo organizatave të tjera për të cilat ato bashkëpunojnë. Kjo periudhë e parashikuar edhe në projektpropozim nuk mund të jetë më e gjatë se një vit. Për këtë arsye edhe në përputhje me orientimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut është përcaktuar e drejta e të dënuarit apo e të paraburgosurit për t'i kërkuar ministrit të Drejtësisë një rivlerësim të kushteve për vazhdimësinë ose jo të këtij regjimi të posaçëm.

Në projektligj me qëllim që të mos i lihet një diskrecion i madh ministrit të Drejtësisë janë përcaktuar edhe kriteret se ku do të bazohet vendimi i ministrit të Drejtësisë për rivlerësimin e situatës. Pas rivlerësimit të kushteve dhe urdhrit të ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e këtij regjimi të posaçëm ose jo për një periudhë tjetër njëvjeçare i dënuari, i

paraburgosuri apo avokati mbrojtës, kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë, nëse e shikojnë të arsyeshme. Pra, duke i dhënë mundësinë edhe të ankimit për të respektuar edhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregull ligjor.

Përcaktimin e subjekteve që do të trajtohen me modelin e ri e bën neni 28 i Kodit Penal, që trajton format e veçanta të bashkëpunimit duke radhitur në këtë aspekt edhe grupin e strukturuar kriminal, organizatën kriminale, bandën e armatosur, por edhe me një specifikë tjetër që janë organizatat terroriste. Duke u nisur edhe nga elementët apo edhe propozimet e ardhura nga agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare që i kushtojnë një rëndësi të veçantë edhe rasteve të organizatave terroriste, që sot janë një problem dhe një rrezik i madh në vendet europiane apo edhe në kontinentin tjetër janë përfshirë në këtë regjim të posaçëm dhe ata elementë që janë pjesë e organizatave terroriste me karakter terrorist.

Sipas paragrafit 5 të nenin 28 të Kodit Penal, parashikohet se krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal, cilësohen si vepra dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose dispozitave të tjera penale të veçanta.

Po sipas paragrafit 6, të këtij neni anëtarët e organizatës kriminale dhe organizatave terroriste, të bandave të armatosura, të grupeve të strukturuar kriminale janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

Duke u nisur nga përcaktimi i nenit 28 të Kodit Penal, legjislatori ka përcaktuar vendosjen e subjekteve të krimit të organizuar me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim në një burg të sigurisë së lartë. Përveç kësaj kategorie në burgun e sigurisë së lartë sipas parashikimeve aktuale të bëra në nenin 13 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” vendosen edhe të dënuar të tjerë, të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime dhe sjellje të cilat e bëjnë të pamundur qëndrimet në burgjet e kategorive të tjera.

Sipas këtij parashikimi në burgun e sigurisë së lartë vendosen direk nga gjykata, në momentin që jep vendimin për subjektet e krimit të organizuar apo të gjithë elementet që përmenda pak më lart, ndërsa për të dënuarit e tjerë mund të lihet në dorë të gjykatës për ta çmuar apo vlerësuar nëse është vendi për t’i vendosur këta të dënuar në burgun e sigurisë së lartë ose jo.

Për këtë kategori të dytë, legjislatori ka parashikuar në nenin 13 të ligjit se kur gjykata nuk është shprehur me vendim për vendin se ku do të vuhet dënimi dhe është rasti

që dënimi të vuhet në burgun e sigurisë së lartë, atëherë kjo gjë bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë. Në bazë të paragrafit të tretë të nenit 13 të ligjit në burgjet e sigurisë së lartë vihen kufizime për të drejtat e të dënuarve në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Nisur nga ky parashikim edhe në kuadër të situatës emergjente në të cilën po kalon lufta ndaj krimit të organizuar Ministria e Drejtësisë vendosi që të hartojë këtë projektligj me qëllim kufizimin e disa të drejtave të të dënuarve që janë pjesë e krimit të organizuar.

Në paragrafin e parë janë përmendur saktësisht dispozita, nenet me të cilët zbatohet ky regjim i posaçëm. Këto nene dënojnë jo vetëm krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, terroriste apo bandë të armatosur dhe grup i strukturuar kriminal, por edhe vepra penale të tjera, të cilat kryhen nga anëtarët e krimit të organizuar në kuadër të përmbushjes së qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

Më pas, po në këtë paragraf janë parashikuar një sërë masash që duhet të ndërmerren edhe ndaj të dënuarve për këto vepra penale dhe ndaj të paraburgosurve që heton apo janë në proces gjykimi po për këto vepra penale, pasi nuk do të ishte e plotë nëse ky parashikim do të ishte vetëm për ata të cilët kanë marrë një vendim të formës së prerë nga gjykata dhe linin jashtë kategorinë e të paraburgosurve të cilët dyshohen dhe gjykohen po për të njëjta vepra penale.

I është lënë gjykatës për ta vlerësuar dhe për të dhënë se ku do të ekzekutohet vendimi dhe për cilat raste apo kategori do të vendoset ky kufizim i të drejtave, duke e gjetur zbatimin të dispozitat e cituara në paragrafin e parë, me qëllim që të mos i lihet një diskrecion i zgjeruar ministrit të Drejtësisë. Nëse modeli italian sot e ka se e përcakton dhe vendos ministri i Drejtësisë nëse kjo kategori individësh apo elementësh kriminalë do të vendosen në këtë regjim të posaçëm, me propozimin tonë është pikërisht gjykata, e cila e vendos këtë duke e lidhur edhe me dispozitat me të cilat dënohet, më pas duke i lënë gjithmonë atë garanci që edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, e ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme rishikimin e këtij kufizimi, me qëllim që të mos jetë i përhershëm, i përhershëm apo të mos jetë deri sa të zgjasë koha e vuajtjes së dënimit.

Ky është pak a shumë parashikimi i propozuar nga Ministria e Drejtësisë lidhur me masat emergjente që duhet të merren për luftën kundër krimit të organizuar.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin nga ana juaj!

Më duhet t'ia kaloj fjalën relatorit për relatimin nga ana e tij. Pastaj kolegët janë të ftuar për t'i drejtuar pyetje Ministres, stafit që e shoqëron, si edhe relatorit.

**Pjerin Ndreu** - Faleminderit, zonja kryetare!

Unë nuk dua të shtroj shumë gjëra nga ato që tha Ministrja, sepse i bie që të themi të njëjtën gjë, por për sa kohë kemi të bëjmë me një kategori të dënuarish ose të paraburgosurish, bëhet fjalë për vepra tepër të rënda dhe kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste apo vepra me qëllime terroriste, që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe këta duhet t'i nënshtrohen një regjimi të veçantë, kjo natyrshëm na bën që të jemi pro dhe në mbështetje të këtij propozimi.

Ato që dua të them si relator janë modalitetet sesi do të zhvillohet kjo, sepse ka të bëjë e para, me burimet njerëzore që ta realizojnë këtë.

Cila është marrëdhënia në pikëpamjen e komunikimit me persona të jashtëm të burimeve njerëzore, që punojnë aty me të dënuarit. A janë këta interlokutorët mes të burgosurve dhe personave jashtë? Ky është një problem që duhet parë me shumë kujdes, se, nëse ne izolojmë personat, çfarë ndodh me personelin, i cili në shumë raste ka shfaqur problematika, pra ka marrë e ka çuar informacione edhe duke i koduar dhe duke bërë një punë, të cilën ne nuk e shmangim dot as në izolim?

Unë mendoj se qëllimi është i duhuri dhe ne do ta mbështesim, ndërsa te modalitetet duhet ta shohim më me kujdes, që të realizojmë realisht qëllimin që ka ky projektligj. Pra, ne të rregullojmë edhe disa momente të tjera që kanë të bëjnë në arritjen e asaj që duam realisht, që këta persona të izoloohen dhe të mos kenë kontakte kriminale me të tjerë dhe këtu ka disa problematika, të cilat duhet të sqarohen.

Po e mbyll duke qenë pro dhe duke i ndenjur strikt qëllimit për të cilin ka ardhur ky projektligj, ndërsa në shpjegimin e disa detajeve, ia rezervoj të drejtën vetes dhe kolegëve, që nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve ne të sqarojmë disa momente të tjera, të cilat do të na bëjnë të besojmë se kjo është e realizueshme në kushtet e problematikave që ka ky vend, por edhe institucionet tona që nga ministria, institucionet penitenciare, policia, niveli i jetesës, prokuroria etj., sepse, të mos harrojmë, jemi në fazën e reformimit të drejtësisë që është një ndër indikatorët më të fortë në rastin konkret. Drejtësia është aksi ku do të përcaktohet edhe pozita e personave të dënuar apo të paraburgosur në raport me masën që do të merret, se nuk ka asnjë institucion tjetër që do ta bëjë këtë.

Ne duhet ta mbështesim si qëllim, por duhet të shohim momentin.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Ndreu!

Në fakt, më duket me shumë vend fjala e zotit Ndreu për të diskutuar hollësisht modalitetet e zbatimit të këtij regjimi të posaçëm që kërkohet të vendoset ndaj të dënuarve në burgun e Sigurisë së Lartë, por jo vetëm ndaj të dënuarve, por edhe ndaj të paraburgosurve, gjithmonë për ata të dënuar apo ata të paraburgosur që hetohen dhe gjykohen për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, ku hyjmë të gjitha format e shfaqjes së krimit të organizuar, që nga grupi i strukturuar kriminal, tek organizatat, bandat e armatosura, organizatat terroriste, gjëra të cilat janë të sqaruara tanimë shumë qartë në Kodin Penal.

Kuptohet që në qëllim e gjitha duket logjike edhe unë do ta ftoja zonjë Ministre, që më shumë se sa ta prononconim si një situatë emergjente të krimit të organizuar, ta prononconim këtë amendim si një adresim më të mirë në luftën kundër krimit të organizuar, sepse edhe ju vetë e përmendët në fjalën tuaj që gjatë këtyre viteve, dhe jo vetëm në një vit, është bërë një përpjekje e shtuar jo vetëm nga institucioni që ju përfaqësoni, por edhe nga Ministria e Brendshme posaçërisht, për të qenë në krye të kësaj lufte. Ka pasur edhe mekanizma ligjorë, edhe të tjerë, s'është oracioni "Forca e ligjit", që janë ndërtuar dhe janë detajuar më vonë pikërisht për të qenë një vlerë e shtuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe natyrshëm, edhe ne si anëtarë të këtij komisioni, propozimin që ju na sillni sot e shohim si një vlerë të shtuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Ne kërkojmë që persona të dënuar që hetohen apo gjykohen për vepra që lidhen me krimin e organizuar të mund t'i parandalojmë nga kryerja e veprave të tjera penale, pra të ndalojmë urdhërdhënien nga burgjet (e thënë me fjalë të thjeshta). Është një fenomen që ndodh, ndodh edhe me bashkëpunim e personave që trajtojnë të dënuarit në institucionet ku ekzekutohen vendimet penale.

Megjithatë se sa është madhësia e këtij problemi kjo është një gjë që besoj do ta trajtojmë nëpërmjet pyetjeve dhe jam shumë dakord që në momentin që ne do të kalojmë në diskutimin e nenit, të mos e trajtojmë atë thjesht si një nen, por të trajtojmë çdo pikë të atij neni, me qëllim që të ruajmë balancën. Ky regjim është i vlefshëm, por nga ana tjetër të mos e mohojmë që ka marrë edhe kritika për faktin që duke i izoluar njerëzit ekziston gjithmonë rreziku që ata të degradohen.

Qëllimi që ne kemi është që këta të mund të riintegrohen në shoqëri, kështu që duhen vendosur edhe këto instrumente që sigurojnë balancën ndërmjet qëllimit dhe nevojës që kemi dhe rezultatet që do të merrim në fund.



Keni një material përpara, ku shprehet qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë, por është edhe opinionin e EURALIUS-it. Ne përfituam nga fakti që në Komisionin e Ligjeve ky diskutim është çelur tanimë dhe është marrë edhe mendimi i EURALIUS-it dhe e keni tanimë të gjithë përpara mendimin e EURALIUS-it për këtë projekt.

Urdhëroni, zoti Sterkaj!

**Paulin Sterkaj** - Faleminderit!

Përshëndetje zonja Ministre!

Kisha një pyetje: Që ta miratojmë këtë projektligj ne duhet të dimë se çfarë ka ndodhur deri më sot. Sa raste janë identifikuar dhe hetuar për grupet kriminale që kanë implementuar veprimtari kriminale nga burgu jashtë tij?

**Ermonela Felaj** – Urdhëroni, zonja Ministre!

**Etilda Gjona** – Në momentin që ne do të kishim disa të dhëna që sa nga elementët kriminalë, grupet, apo organizatat kriminale që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale kryejnë aktivitetin, do të thotë që ne këto individë duhej t'i kishim çuar për procedim penal për herë të dytë apo të tretë.

Fakti që nuk ka të dhëna të tilla, nuk do të thotë se nuk ekziston si fenomen, sepse e dimë mjaft mirë si nga shërbimet informative, ashtu edhe nga shërbimi i brendshëm i sigurisë së kontrollit të burgjeve, informacione në mënyrë të vazhdueshme lidhur me mbajtjen e kontakteve të personave, individëve specifikë që kanë qenë pjesë e këtyre grupeve kriminale dhe që ndodhen sot në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, se ata vazhdojnë të mbajnë kontaktet me ata që ndodhen jashtë.

Do të ishte e pamundur për mua si ministre Drejtësie, po jam e sigurt që çdolloj institucioni nuk do të mund të jepte një shifër lidhur me faktin se sa nga këta persona kryejnë aktivitet kriminal, sepse do të thotë që ne tashmë do t'i kishim çuar për procedim penal në prokurori.

Nuk është thjesht një propozim që vjen me të dëgjuar apo për të parandaluar një rrezik të hamendësuar, por për shkak të informacioneve të vazhdueshme që na vijnë, edhe nga organet ligjzbatuese të huaja dhe kryesisht nga shteti italian, ne po ndërmarrim këtë masë sot, me qëllim që të parandalojmë atë çfarë ndodh jashtë, kur këto grupe kriminale që janë brenda instruktojnë apo japin urdhra nga brenda sistemit penitenciar.

Nëse me lejoni të përmend, zonja kryetare, dy-tre elemente që lidhen me shqetësimet e zotit Ndreu, që pak a shumë ishin si pyetje, por njëkohësisht edhe shqetësime. Unë do t'ju thosha që, për sa i përket modaliteteve të zbatimit, lidhur me disa gjëra të përgjithshme,

njëkohësisht në mënyrë paralele një grup pune i Ministrisë së Drejtësisë, bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve po punojnë për të përgatitur paketën e protokolleve të zbatimit të këtij ndryshimi apo regjimi të posaçëm. Në këtë përgatitje, në këtë grup pune kemi në mënyrë të vazhdueshme ekspertizën e prokurorisë antimafia italiane, që ka zbatuar më herët këtë regjim të posaçëm.

Nga ana tjetër, mund të them që sot takimet e personave apo elementëve kriminalë me një rrezikshmëri më të lartë se individët e tjetër që ndodhen në regjime të zakonshme vijnë jo vetëm për shkak të bashkëpunimit shpeshherë të identifikuar edhe nga ana jonë me stafin e institucioneve të regjimit të brendshëm apo stafin e institucioneve të burgjeve, por kjo zakonisht bëhet për shkak të numrit të lejuar që ata kanë nga ligji, i cili është shumë një numër më i lartë nga ai që parashikojmë dhe propozojmë në këtë nen.

Nëse sot çdo person i dënuar apo i paraburgosur ka të drejtën që të ketë katër takime, me ndryshimet duhet që ky person të ketë vetëm një takim dhe shumë të kufizuar, shumë mirë të përcaktuar rrethin e individëve që takon, duke përfshirë vetëm rrethin e ngushtë familjar.

Duke pasur dhe duke zbatuar këtë do të arrijmë të eliminojmë mundësinë që këta elementë kriminalë të kenë mundësi të takojnë persona të tjerë.

E dyta, një vlerë të shtuar do të ketë pikërisht regjimi i posaçëm, kufizimi i të drejtave për këta elementë kriminalë për të mos pasur mundësi të kontaktojnë me disa elementë të tjerë kriminalë të cilët ndodhen po ashtu në të njëjtin regjim të sigurisë së lartë në sistemin e burgjeve apo të sigurive të tjera.

Paralelisht, ky ndryshim, ky propozim, po shoqërohet edhe me disa investime të cilat kanë të bëjnë me rritjen e elementeve të sigurisë në sistemin penitenciar.

Jemi duke punuar për ngritjen e një salle operationale, e cila do të jetë e lidhur 24 orë me të gjitha kamerat e të gjitha institucioneve penitenciare, duke filluar fillimisht shtrirjen në ato të sigurisë së lartë, ku do të zbatohet regjimi i posaçëm dhe më pas edhe në të 24 institucionet e tjera dhe njëkohësisht me të gjithë skanerët të cilët mundësojnë kontrollin e hyrjes së elementeve, pajisjeve të palejueshme në sistemin penitenciar. Është e vërtetë që është një situatë emergjente, por ashtu siç edhe ju, zonja kryetare thatë, fakti që vjen ky propozim është pikërisht për ta adresuar, nuk ka asnjë lloj qëllimi tjetër, është për ta adresuar më mirë me marrjen e masave konkrete, të cilat në disa raste mbase janë pak të ashpra, por janë pikërisht për të bashkërenduar forcat në luftën kundër krimit të organizuar. Nuk është një

ndjeshmëri dhe një nevojë që vjen vetëm nga brenda vendit, por vjen edhe nga partnerët tanë kryesisht agjencive ligjzbatuese të huaja.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Urdhëroni, zoti Sterkaj!

**Paulin Sterkaj** - Unë ju pyeta ju, jo zotin Ndreu, se zoti Ndreu referoi. Unë do të doja të dija një rast të vetëm të identifikuar, se ju si ministre e Drejtësisë duhet ta dini. Ndoshta informacionin mund ta ketë zëvendësministri i Brendshëm, sepse unë e kam gjithmonë me frikë se ne marrim shembull Italinë, po Italia i ka me prova këto. Janë bërë skenarë filmash që nga Italia deri në Hollivud për ngjarjet që kanë ndodhur, për kriminalitetin në Itali. Në Shqipëri ku e kemi rastin? Ne duhet të dimë shqetësimin aktual që kemi në Shqipëri, se më duket sikur do të jenë disa elemente që edhe mund të ngarkohet dikush padrejtësisht, se mund të ndodhë që njeriu të kryej krim, mund ta kryej edhe pa dashje, por që t'i shtrëngohet e drejta dhe liria, që të ketë mundësi të kthehet, siç e tha edhe kryetarja e komisionit, të riedukohet dhe të bëhet si duhet, kjo nuk shkon, Ne japim masa shtrënguese sepse ai ka bërë një gjë që ka mundësia të ketë qenë krejt aksidentale.

Unë do të doja të dija rastet në Shqipëri dhe pse vijnë këto masa shtrënguese? Ku është rasti? Ku është shqetësimi? Ku është fenomeni?

Ne mund t'i largojmë mediat dhe të flasim me dyer të mbyllura, por duhet t'i dimë këto gjëra që të jeni të qartë kur votojmë një projektligj, jo të merremi me fjalë që xhirojnë në Itali, jo partnerët, jo ato, jo këto. Shpeshherë i dëgjojmë këto partnerët dhe na vijnë shumë gjëra nga partnerët, por kur vjen puna ne nuk bëjmë si partnerët. Partnerët janë shumë më lart se ne.

A jemi ne të zotë të bëjmë atë që duhet dhe të vemën pikat mbi “i”?

**Ermonela Felaj** – Unë besoj se ndjeshmëria e kolegut është me vend, në fakt, sepse edhe në Itali, kur u vendos neni 41 biss, nuk doli rastësisht. Pati një situatë realisht shumë të rëndë, pasi kishin ndodhur shumë goditje të trupave të policisë, u goditën Borselino dhe Falkone dhe pasi ndodhën këto ngjarje u pa ky lloj reagimi, ndoshta në mënyrë të përgjithshme, por drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve apo zëvendësministri i Brendshëm mund të na referojnë situata të ngjashme, kur persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke qenë të dënuar, kanë ndikuar edhe në kryerjen e veprave të tjera penale jashtë burgut. Është tjetër gjë që në opinion publik, nga media e shkruar, kemi dëgjuar për raste të tilla. Një informacion nga ju, që jeni në kontakt të drejtpërdrejtë, do të na ndihmonte për ta çmuar më mirë përhapjen e këtij fenomeni në burgje. Pra, kjo nuk është një situatë e padëgjuar, jo

vetëm për deputetët e këtij komisioni, por për këdo qytetar. Për shkallën e përhapjes së fenomenit dhe sa i rrezikshëm është bërë ai, besoj se mund të na ndihmoni. Këtu ishte edhe ndërhyrja nga ana e kolegut.

Ne e thamë, e tha edhe relatori në emër të të gjithë komisionit, absolutisht, qëllimi është pozitiv, por gjithmonë duhet të kujdesemi për të ruajtur balancën midis nevojave që kemi dhe të drejtave, që natyrshëm nuk mund t'u mohohen të dënuarve ose të paraburgosurve.

Zoti Çipa, mund të na thoni diçka për këtë?

Nëse e keni ju informacionin, patjetër...

**Etilda Gjonaj** – Patjetër, le ta marrë fjalën drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, por unë doja t'ju thosha diçka të përgjithshme. Ne nuk kemi statistika se sa persona përfshihen në veprimtari të jashtëligjshme, duke përfshirë edhe ata që janë jashtë.

Të mos harrojmë që indiciet ne i marrim nga informacioni që na sjell Shërbimi Informativ. Shërbimi Informativ e ka të klasifikuar informacionin.

Nëse do t'ju duhet një informacion i tillë për të vlerësuar nismën që është propozuar nga Ministria e Drejtësisë dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave, mund t'ju sjellim një informacion me shkrim për rastet kur Shërbimi Informativ apo Shërbimi i Brendshëm i Sigurisë dhe Kontrollit në Burgje kanë sjellë për shqetësime të tilla të ngjashme. Është një informacion i klasifikuar, i kufizuar... Jeni Komisioni i Sigurisë dhe jam e sigurt që këtë gjë nuk ka nevojë ta them unë. Kaq kisha.

Faleminderit!

**Paulin Sterkaj** – Me leje? Kam për të thënë diçka, sepse duhet të jemi të qartë.

Këto gjërat e përgjithshme nuk i kam qejf, zonja Ministre. Më pëlqejnë gjërat konkrete.

Shërbimi Informativ jep informacionin. Institucione të tjera veprojnë mbi bazën e informacionit. Këto institucionet e tjera kanë qenë në gjumë, që kanë ardhur informacionet për këtë veprimtari, apo janë në aktivitet të përditshëm në punë? Sepse në rast se Shërbimi Informativ jep një informacion, ai natyrshëm do të verifikohet. Nëse informacioni del pa bazë, ai bie poshtë dhe shkon në arshivë.

Këto strukturat e tjera ligjzbatuese, strukturat e tjera të kontrollit, a kanë vepruar mbi bazën e këtyre informacioneve, që kanë ardhur nga Shërbimi Informativ apo edhe nga aleatët? Sepse duhet të ketë diçka... Dhënia e informacionit është një indicie shumë pozitive për të gjetur atë që duhet. Konkretisht, nga institucionet e tjera në bazë të informacioneve që

ka sjellë shërbimi, ju thoni se nuk ka raste. Çfarë të them unë tani...?! Unë nuk bindem për këtë që thoni ju. Nuk e kuptoj se çfarë mund të them përveçse fjalëve të përgjithshme.

**Pjerin Ndreu** – Mund të them diçka në vazhdim të fjalëve të Paulinit?

**Ermonela Felaj- Po.**

**Pjerin Ndreu** – Paulini ka plotësisht të drejtë.

Të sjellësh një ndryshim në ligj, duhet të kesh një indicie, por jo indicie informacionesh. Informacionet e SHKB-së nuk pinë ujë fare në këtë histori.

Ky është i vetmi argument që nuk mund të përdoret, zonja Ministre. Përdoren rastet. Që në kohën e pozitivizmit, të Lombrosos, të Enriko Ferrit e të tjerë ka qenë shtruar problemi i një farë statistike, se sa persona hyjnë në burg dhe nuk kthehen më në aktivitet kriminal dhe sa persona hyjnë në burg dhe kthen përsëri në aktivitet kriminal. Kjo është histori e gjatë.

Në fakt, ky nuk është faji yt, por është i sistemit, që të jemi realistë dhe ta sqarojmë. Është faji i një sistemi të çorganizuar. Sot duhet të kishim një studim, që në sa raste personat që hyjnë në burg implikohen përsëri në veprimtari kriminale gjatë vuajtjes së dënimit (është rasti konkret), duke pasur parasysh edhe krimet e rënda, sepse personi mund të vijë në burg për vrasje, për një krim të lehtë dhe implikohet me rrjete të tjera kriminale apo merr pjesë në një krim edhe më të rëndë. Sa nga këta që hyjnë në burg, dalin dhe marrin pjesë përsëri në grupe kriminale dhe sa...?

Pra, duhet të ketë një studim dhe mekanizmi duhet të funksionojë, gjë që nuk ka ndodhur dhe ky nuk është faji yt, as faji ynë. Ministria e Drejtësisë duhet ta nxisë këtë dhe duhet t'i marrë rastet, sepse janë me çështje penale të caktuara dhe këto nuk bëhen me informacione. Në qoftë se ne merremi me informacione, atëherë hajde të marrim informacionet e opozitës dhe të legjitimojmë ato që thotë opozita, bla-bla-bla... Kjo bëhet me raste të evidentuara, se në sa raste persona të tjerë që kanë hyrë në burg për tjetër gjë janë evidentuar gjatë hetimeve të ndryshme penale që kanë qenë të implikuar në një rrjet tjetër ose gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Ka apo nuk ka? Frika se mund të ndodhë është tjetër gjë.

Pastaj të mos harrojmë se jemi në një sistem që ka masa izoluese, sepse, në fund të fundit, cili është qëllimi i dënimit? Të izolojë personin nga shoqëria për shkak të rrezikshmërisë që ka dhe ta risocializojë, ta kthejë në normalitet gjatë kohës... Pra, për momentin, ne kemi masa kufizuese, kemi edhe masa shtrënguese, në rastet kur sjellja e tyre brenda është në shkelje të ligjit. Pra, e parashikon edhe ligji sot, por nëse ti do t'i vihesh një grupi personash, duhet të kesh një indicie përse do ta marrësh këtë masë. Indiciet nuk merren me informacione. SHKB-ja nuk hyn fare në këtë punë. Informacionet e SHKB-së marrin

vlerë vetëm kur kthehen në prova. Informacioni, në momentin kur merret, është opinion dhe për sa kohë që informacioni nuk kthehet në provë ligjore, me të cilën mund të ngrihet një kauzë apo mund të marrë dënimin një person, nuk ka asnjë vlerë.

Kjo historia që ngremë ne mbi bazën e indicieve të informacioneve, duhet të hiqet një herë e mirë, sepse jemi shtet ligjor dhe nuk jemi shtet thashethemesh. Këto institucionet, madje në raste të caktuara edhe SHISH-i, edhe SHKB-ja e të tjerë, janë bazë thashethemesh, janë njerëz të paaftë që ngrenë thashethemnaja dhe krijojnë alibi.

Pra, duhet të jemi të qartë, të rrimë te qëllimi që tha kryetari dhe unë jam dakord, por, nga ana tjetër, që sot duhet të mendoni që, sa të jetë e mundur, të bëhet një studim me të gjithë personat e dënuar. Pra, ka të dhëna që këta njerëz, që vijnë sot këtu e deri kur të mbarojnë dënimin, janë në rregull, sillen mirë, implikohen në rrjete kriminale... Në qoftë se ka, a ka ndonjë rast kur janë ngritur akuza gjatë kohës së vuajtjes së dënimeve? Sepse nuk të ndalon njeri... Ti mund të kryesh një vepër penale brenda në burg, ngrihet akuza dhe fillon çështja tjetër penale ose qëllon të jesh i implikuar me ndonjë organizatë tjetër jashtë dhe komunikon... Çfarë kanë evidentuar sistemet e komunikimit? Nëse kemi problematika, si zhvillohen këto sisteme komunikimi të personave që janë...? Meqë është problematikë, cilat janë mënyrat e komunikimit? Me letra, me telefona, me kode të ndryshme? Si e transmetojnë komunikimin? Me kë ?

Pra, jam plotësisht dakord me ato që tha Paulini. Duhet një studim i qartë, që të dimë se çfarë...

E thashë, nuk është faji yt, por i sistemit të çorganizuar, që nuk ka asgjë në evidencë. Ti (kushdo tjetër të ishte) nuk ke çfarë të na thuash sot. Çfarë do të thoshe ti?

Ajo e SHKB-së nuk është argument. Miqësisht, po të them të mos e përdorësh më. As Shërbimi Informativ Shtetëror nuk është argument. Ato janë informacione thjesht për të vënë në lëvizje, por nuk janë arsye për të ndërmarrë masa ekstreme. Arsytet për të ndërmarrë masa ekstreme janë vetëm rastet kur personat rezultojnë të implikuar me prova dhe marrin masë dënimi. Nëse në 100 raste në një vit ose në 2 vjet evidentohet se këto grupe që kanë hyrë në burg, gjatë procesit të vuajtjes dënimit, dalin të implikuar edhe në veprimtari të tjera kriminale, atëherë mund të mendojmë se jemi në një situatë problematike. Përndryshe do të shkojmë në logjikën e Lul Bashës dhe Sali Berishës, që këtu të gjithë janë kriminelë dhe këtu bëhet një zhurmë e madhe... Kjo nuk shkon shumë...

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Ndreu!

Besoj se mund ta ftojme zonjen ministre kur do te na duhet ta miratojme ne teresi kete projekt, qe te kemi edhe nje statistikë te recidivizmit per vepra qe lidhen me krimin e organizuar.

Besoj se kjo është nje statistikë qe mund te nxirret. Është rasti per te treguar edhe nje herë qe statistikat nuk janë thjesht numra, por janë numra qe duhet t'u jepet kuptim dhe kuptimin ua japin njerëzit qe e kanë për detyrë, nëpërmjet analizës qe bëjnë te shifrat.

Vërejtja qëndron. Nuk mund te vijë nje propozim thjesht per faktin se kjo është nje gjë qe ka ndodhur ne Itali, e kanë bërë ato dhe hajde ta bëjmë edhe ne. Argumenti vlen gjithmonë. Ne Itali është bërë para 17 vjetësh. Ne jemi 17 vjet mbrapa, argumenti duhet te jetë i plotësuar ne çdo pikë, ne mënyrë qe te gjithë kolegët te jenë te informuar.

Nuk vihet me argumentin qe "ju tani ma bëtë pyetjen". Ju duhet te kini parasysh qe ne kete komision apo ne çdo komision tjetër mund te bëhet çfarëdolloj pyetjeje. Përgatitja ju takon juve. Nuk mund t'ju themi më parë se çfarë pyetjesh do t'ju bëjmë. Megjithatë, nuk dua qe debati i ngelur ne kete pikë te vdekur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk e kishit informacionin. Kështu qe...

Fjala është per zonjen Gjebrea.

**Elona Gjebrea-** Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja Ministre,

I nderuar zoti zëvendësministër,

I nderuar drejtor,

Ne fakt, lexova përmbledhjen shpjeguese te përmbajtjes qe ka projektakti.

Besoj se mund te merret nje informacion më shumë per nje fjali, qe m'u duk pak shqetësuese. Po e lexoj: "Ne kushtet e realitetit shqiptar, nisur nga detyrat qe BE-ja i ka ngarkuar Shqipërisë ne luftën kundër krimit te organizuar, ky fenomen perbën nje situatë emergjente." Kjo tregon qe jemi vërtet ne nje situatë emergjente. BE-ja ka lënë disa detyra ne luftën kundër krimit te organizuar, por, nga ana tjetër, thuhet se projektligji nuk përfiton asnjë akt te *acquis communautaire*, ashtu sikurse edhe nga relacioni i ekspertit te EURALIUS-it thuhet se asnjë shtet tjetër anëtar i Bashkimit Europian nuk aplikon nje regjim te tillë. Këtu shikoj nje kontradiktë ndërmjet asaj çfarë bëjnë vendet e Bashkimit Europian per kete situatë... Nga ana tjetër, kjo tregon se ka nje problematikë, qe, sikurse e thatë, ne qoftë se nuk është e shprehur qartë edhe me statistika, bëhet përsëri e paqartë per ne si anëtarë te Komsionit te Sigurisë.

Nga ana tjetër, fakti që ky projektligj nuk përafron asnjë akt të *acquis communautaire* dhe ndërkohë BE-ja ka lënë këto detyra... Ndoshta unë nuk jam shumë e qartë, por nuk e kuptoj mirë.

Mbase mund të bëni një sqarim në lidhje me këtë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, zonja Ministre.

**Etilda Gjonaj** - Propozimi nuk kërkon me detyrim të bëhet një përafrim me *acquis communautaire*. Është e vërtetë, në të gjitha rastet kur propozojmë projektligjet, shikojmë nëse ka direktiva të Bashkimit Europian. Në rastin konkret nuk ka pasur një gjë të tillë. Kjo është arsyeja pse është shprehur që nuk ka një përafrim, sepse nuk ka pasur një direktivë specifike, pra është çekuar nga drejtoria e kodifikimit, që e ka për detyrë, për të parë nëse ka direktiva të ngjashme, me qëllim që kur të fillojmë procesin *screening* ato të mos jenë më pjesë e paketës që duhet ndryshuar përsëri, por për ta parë që tani. Meqenëse nuk ka një direktivë rekomanduese, do të thotë se nuk kemi ndonjë problem, por nënkuptohet që është në përputhshmërinë e gjithë kuadrit ligjor. Këtë shpjegim ka shprehja që cituat.

Kam një përgjigje për komentin që bëri zoti Sterkaj. Këto nuk janë thjesht informacione që vijnë nga SHISH-i apo nga SHKBB-ja e Burgjeve. Ta ndajmë një herë e mirë SHKBB-në e burgjeve që ka qenë dikur me atë që është sot, e cila ka ndryshuar tërësisht fizionominë e saj. Pa diskutim, janë ende shumë për të bërë, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është vlerësimi juaj, zoti Ndreu. Nuk di të them... Nëse do të kërkon një vlerësim të SHKBB-së është tjetër gjë.

Të gjitha rastet e informacionit, që na vijnë nga SHISH-i apo nga SHKBB-ja, nuk janë thjesht raste që ne i mbajmë në tavolinë, por ato janë referuar në polici dhe në prokurori. Për momentin janë në proces hetimi. Prandaj, e thashë, nuk është se nuk e kam informacionin, por meqenëse është një informacion i klasifikuar dhe meqenëse rastet janë në proces hetimi me policinë dhe prokurorinë... Rastet e fundit, për të cilat ne kemi pasur informacione për kontaktet nga jashtë-brenda apo nga brenda-jashtë, do t'jua sjell me një përgjigje me shkrim.

Ky propozim dhe kjo iniciativë nuk është marrë vetëm për faktin se është bërë në Itali dhe ne po e replikojmë, përkundrazi, ne morëm modelin italian për të kuptuar që është një model i mirë për t'u zbatuar dhe u përgjigjet nevojave, ashtu siç kërkohej në Itali para 17 vjetësh dhe sot në Shqipëri. Nuk ka lidhje me "hajde të marrim modelin dhe ta zbatojmë



këtu”. Kemi nevojë sot për ta marrë këtë model. Raste ka. Të gjitha rastet janë në proces hetimi. Kemi qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Brendshme, me Policinë e Shtetit dhe me Prokurorinë e Përgjithshme, për të gjitha informacionet sekrete që na kanë ardhur nga dy burimet e brendshme, por edhe nga informacionet e jashtme. Kjo është arsyeja pse nuk mund t’ju jap informacionin, sepse është një informacion i klasifikuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj**- Këtë mund ta sigurojmë ne. Mund të lëmë diçka përpara votimit... Mund të nxjerrim kamerat jashtë dhe mund ta marrim këtë informacion, meqenëse është...

**Etilda Gjonaj**- Dakord, por të mos harrojmë se nëse ka ndonjë mesazh që vjen nga burgu e të tjerë. Ju e mbani mend edhe kur diskutohej ligji për lojërat e fatit, pikërisht shprehjen e Kryeministrit se mesazhet që u kishin shkuar një sërë deputetëve, kishin ardhur nga burgu. Kjo nuk është një gjë, të cilën e ndjen dhe ka thjesht një ndjeshmëri apo është një problematikë që ne duam ta bëjmë, por është një fakt real. Kur kamera të dalë jashtë, unë do t’ju jap patjetër 2-3 rastet e fundit që ne kemi pasur shqetësim dhe që kanë marrë njëkohësisht vlerë në këtë propozim.

**Ermonela Felaj** – Vijojmë me pyetjet e kolegëve!

Urdhëroni, zoti Ndreu!

**Pjerin Ndreu** – Meqenëse përmende SHKB-në, po ju them vetëm një fakt, që e kam mësuar nga burime të brendshme. Mbi 200 veta u votuan me një procedurë krejt ndryshe (me akademi, me test me vlerësim e me të gjitha) e, në mos gabohem, në 400-380 veta SHKB-ja ka dhënë përgjigje pozitive vetëm për 10 veta. Për të gjithë të tjerët e ka dhënë negative. Ajo nuk është ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ju them se në këtë rast, për 90% të atyre që kanë marrë pjesë, SHKB-ja u ka dhënë përgjigje negative, megjithëse formula e rekrutimit ishte shumëfish dhe këtë e iniciuat ju, zonja Ministre. Kjo tregon se i gjithë mundi që bëtë, u hodh poshtë nga SHKB-ja, që nuk e ka idenë fare. Po ju them unë që ka raste skandaloze. Sikur të jetë ai shërbim më në formë, do të kishte të tjerë parametra edhe shërbimi i brendshëm. Ka probleme.

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, kolegë!

Të lutem, zonja Ministre!

Jo, nuk është kjo tema për të cilën ju kemi thirrur!

Ju lutem!

Ne mund të bëjmë një mbledhje të posaçme vetëm për SHKB-në. Sot nuk kemi në analizë SHKB-në, por kemi në analizë këtë ndryshim që ju keni sjellë. Për ta vijuar diskutimin, po ju pyes: cila është ideja juaj për të gjithë të dënuarit që vendosen në burgun e sigurisë së lartë, që janë dënuar për veprat penale që ju i përmendni në propozimin tuaj, të gjithë këta duhet të kalojnë automatikisht në regjimin e posaçëm?

**Etilda Gjonaj** – Prandaj është përcaktuar gjykata, si organi, i cili do të vlerësojë për këto kategori, për këta elementë kriminalë, të cilët, gjykohen, hetohen dhe dënohen për këtë kategori veprash penale që do të jenë dhe do të vuajnë dënimin në sigurinë e lartë, nëse do të jenë pjesë e regjimit të posaçëm me të drejta të kufizuara. Është gjykata ajo që e vendos

**Ermonela Felaj** – Atëherë, gjykata sipas ligjit për trajtimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve është ajo që vendos dhe përcakton regjimin e burgut, pra nëse i dënuari do të shkojë në një burg të sigurisë së lartë, në një burg të sigurisë së zakonshme apo në një burg të sigurisë së ulët. Në momentin që ju thoni se të gjithë ata që vendosen në një burg të sigurisë së lartë për 1-2-3-4-5 vepra, ashtu siç i keni numërtuar këtu, këta të gjithë automatikisht do të kalojnë në regjimin e posaçëm? Ky është qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë, apo ndërmjet tyre ju do të veçoni njerëz që kanë prirje për të vijuar aktivitetin kriminal nga brenda burgut? Po pyes për të ditur qëndrimin tuaj.

**Etilda Gjonaj** – Atë do ta vlerësojë gjykata. Nuk është se merret vendim automatikisht, por brenda kësaj kategorie veprash penale dhe elementësh kriminalë, gjykata vlerëson të gjitha rrethanat nëse kjo kategori duhet të jetë në regjim të posaçëm të sigurisë së lartë, sepse gjykata vendos nëse një person shkon në regjimin e sigurisë së lartë apo jo, ndërsa për sigurinë e tjera e përcakton prokurori.

**Ermonela Felaj** – Atëherë, e bëra këtë pyetje, sepse në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë nuk shkojnë vetëm njerëzit që kryejnë vepra penale të terrorizmit, të mbështetjes nga ana financiare të terrorizmit, të grupit të organizuar kriminal e i gjithë katalogu i veprave që numërohen këtu, por shkon edhe ai që kryen një vrasje për gjakmarrje, sepse për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqet, gjykata edhe sipas kërkesës dhe të dhënave që i vë në dispozicion prokurori, çmon që ky person duhet të shkojë në një burg të sigurisë së lartë. Kështu siç ka ardhur propozimi, natyrisht, kjo kategori nuk duhet të futet në një regjim të posaçëm të sigurisë së lartë. Siç është shkruar propozimi, i bie që pavarësisht nëse ti paraqet ose jo rrezikshmëri, mjafton të jesh i dënuar për një nga veprat penale që thuhet këtu, dhe ti duhet të kalosh automatikisht në regjim të posaçëm. Po shoh që ju jeni të qëndrimit që përkon me qëndrimin që ka shprehur edhe EURALIUS-i, që

vendimin se në cilin burg do të shkojë i dënuari, ta çmojë edhe gjykata, pra ti do të shkosh në burgun e sigurisë së lartë për shkak se ti je person shumë i rrezikshëm, i vështirë për t'u menaxhuar brenda burgut si të gjithë të tjerët.

Pyetja tjetër, që kam dhe nuk do të zgjas më por do t'ua kaloj fjalën kolegëve, është: ju mendoni që ministri i Drejtësisë kur të vendosë për revokimin ose jo të regjimit të posaçëm mbas një viti, ka të nevojshëm më shumë mendimin e ministrit të Brendshëm apo atë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë?

**Etilda Gjonaj** – E kemi vlerësuar të jetë ministri i Brendshëm, duke menduar që ka të përfshira edhe disa struktura. Pa diskutim, drejtori i Përgjithshëm të Policisë është ai, i cili do t'i japë mendimin ministrit të Brendshëm, por ka disa struktura vetë Ministria e Brendshme dhe kjo është arsyeja që është lënë të vendosë ministri i Brendshëm, pasi merr informacionin nga të gjitha strukturat e tij.

**Ermonela Felaj** – Për cilat struktura të tjera bëhet fjalë?

**Etilda Gjonaj** - Mund të jetë drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ndërkohë, ministri i Brendshëm ka edhe SHÇBA-në. Pra, mund të jetë një informacion i kryqëzuar që merret nga të gjitha institucionet, që ministri i Brendshëm ka në varësi, duke përfshirë edhe strukturat e brendshme.

**Ermonela Felaj** – A nuk ju duket sikur po e politizojmë shumë këtë proces duke futur në lojë 2 ministra për të marrë një vendim të tillë, ndërkohë që mund ta depolitizojmë pak duke vendosur drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, i cili i ka të gjitha mundësitë për të pasur informacionin për lidhjet jashtë dhe brenda të një personi të paraburgosur apo të dënuar?

**Etilda Gjonaj** – Mund të jetë drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Për mua nuk ka asnjë problem, por ideja është që të kryqëzohen informacionet. Pra, atë informacion që drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nuk e ka, e ka ministri i Brendshëm, i cili ka disa struktura të tjera, ku merr informacionin. Nuk shoh që ky të jetë ndonjë problem shumë i madh në rastin konkret, nëse do të jetë edhe vetë drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. E kemi bërë që të jetë më shumë një cikël i mbyllur për të gjithë pjesën e informacionit.

**Ermonela Felaj** – Kisha edhe një pyetje të fundit: A do ishit ju dakord që në vlerësimin që bën ministri i Drejtësisë që një person (një i dënuar ose një i paraburgosur) të vijojë regjimin e posaçëm? Ky më shumë besoj se do të jetë rasti i një të dënuari që të qëndrojë në regjim, që të marrë mendimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, sepse kjo

prokurori së shpejti do të krijohet dhe kjo prokurori nuk mbulon vetëm akuzat, që lidhen me zyrtarët e lartë, por mbulon të gjitha veprat penale që lidhen me korrupsionin, pavarësisht nga vendi i ndodhjes së veprës apo nga vendbanimi i atij që e kryen veprën, është kjo prokurori që do ta mbulojë. A mendoni se do të ishte me vend që në rastin e propozimit të këtij projekti ne të përfshinim në komunikim edhe drejtuesin e ardhshëm të SPAK-ut? Ky është një propozim që e ka shtruar EURALIUS-i dhe unë do të doja të dija qëndrimin tuaj.

**Etilda Gjonaj** – Kjo është një gjë që edhe ne e kemi menduar dhe e kemi diskutuar gjatë, por po të vini re të gjitha veprat penale të vendosura në paragrafin e parë të këtij neni, disa prej tyre nuk janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Për të evituar rastet që nuk janë brenda kompetencës së hetimit nga SPAK-u, kemi menduar të jetë mendimi i kujtdo prokurori apo drejtuesi, i cili merret me çështjen specifike, meqenëse disa dispozita janë jashtë kompetencës lëndore të SPAK-ut. Kjo është arsyeja pse është lënë që ministri i Drejtësisë merr mendimin e prokurorit.

Duke mbajtur në konsideratë edhe sistemin e ri të drejtësisë penale, ku prokurori ka pavarësi në hetimin e çështjes së tij, do të thotë që do të ishte më me vlerë, që ministri i Drejtësisë të marrë mendimin e prokurorit.

Mund të lihet për ato raste, kur kompetenca lëndore përfshin ato dispozita me të cilat hetohet, gjykohet, apo dënohet një element kriminal, që të merret me këtë edhe drejtuesi i SPAK-ut sipas rasteve të kompetencës së tij.

**Ermonela Felaj** - Dua të shpreh vetëm diçka. Ndoshta do të kemi kohë ta shohim, por mua më rezulton se SPAK-ut nuk i mungon kompetenca, sepse ju vërtet i keni renditur këto vepra, që po t'i marrësh veç e veç, nuk janë të gjitha në kompetencën e SPAK-ut, por ne kemi thënë rastet e këtyre veprave, kur kryhen në trajtën e njëjës nga format e krimit të organizuar, pra këta persona, që dënohen për këto vepra penale, por të kryera në këtë trajtë, do të jenë në regjim të posaçëm dhe jo të jenë të dënuar thjesht për atë vepër. Megjithatë, do të kemi kohë ta diskutojmë.

Unë do t'ia lë fjalën kolegut Vorpsi për një pyetje dhe më pas, zonja Gjebrea donte të ndërhynte sërish.

**Sadi Vorpsi** – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja Ministre

Sigurisht, unë e vlerësoj këtë projektligj, por shqetësimi im, si ligjvënës, por edhe për shkak të disa shqetësimeve të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në buxhetin që ne sapo kaluam këtu dhe, sigurisht edhe në raport me këtë projektligj është trajtimi i atyre burimeve

njerëzore në institucion. Kemi të bëjmë me elementë kriminalë, që kërkojnë patjetër edhe trajtimin e burimeve njerëzore ndryshe.

A keni parashikuar në këtë projektligj një trajtim ndryshe për këtë kategori?

Unë mendoj që kërkohet patjetër një trajtim ndryshe i këtij personeli. Ne këtu nga raportimi dhe nga kërkesat e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kemi marrë edhe disa kërkesa nga disa institucione të vuajtjes së dënimit, ku numri i punonjësve është nën atë kriter që përcakton ligji. Kjo ishte pyetja ime, që ka lidhje me trajtimin e këtyre burimeve njerëzore në raport me këtë kategori të dënuarish.

**Ermonela Felaj** – Urdhëroni, zoti Cipa!

**Stefan Cipa** – Realisht, për trajtimin e punonjësve të Policisë së Burgjeve, ne kur kemi diskutuar buxhetin aktual në këtë komision, kemi thënë nevojat për mënyrën e trajtimit, siç ka qenë në raport me policinë e tjera, por edhe në raport me asetet kriminale që trajtohen brenda nëpër burgje. Në qoftë se si numër total asetesh i kemi, sepse do të trajtohen në burgjet e sigurisë së lartë, ndërsa për problemet e tjera që ne kemi diskutuar te buxheti, një pjesë shumë e vogël e tyre u mor parasysht. Të tjerat jemi duke i zgjidhur në vazhdim.

Për sa i përket infrastrukturës së logjistikës, edhe nëpërmjet buxhetit, por edhe nëpërmjet donatorëve të tjerë, jemi duke e përmirësuar. Flas për lidhjen që do të ketë salla operative jo vetëm me sistemin e kamerave, por edhe me skanerë të ndryshëm me të cilët jemi duke i kompletuar burgjet e sigurisë së lartë. Për zgjidhjen e këtyre problemeve me gjithë shtesat që kemi bërë, përsëri ka shumë për të bërë.

**Ermonela Felaj** - Në fakt, ne e ngritëm këtë problem edhe në Komisionin e Ekonomisë mbas diskutimit me ju. Di që edhe ju vetë jeni investuar në Komisionin e Ekonomisë që këto kërkesa të zgjidheshin, megjithatë nga debati që kemi pasur me ministrin e Financave, u la që kjo çështje të zgjidhej me Ministrinë e Drejtësisë, duke parë rialokimet e zërave për të bërë të mundur edhe plotësimin e kapaciteteve, edhe sigurimin e sallës operative, që përmendi zonja ministre.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

**Elona Gjebrea** – Pavarësisht se ky është një diskutim i tejkaluar tashmë, përsëri jam në mbështetje të një buxheti më të lartë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të gjitha problematikat, që u sqaruan me detaje këtu në diskutimin me ta.

Kam vetëm një sugjerim që ka të bëjë me faqen e fundit, ku thuhet: “Ministri i Drejtësisë vendos zgjatjen e afatit për periudha të tjera...”

Unë mendoj se duhet të shtohet: me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, sepse kur vendoset për zgjatjen e afatit, dikush e propozon këtë zgjatje afati.

Më pas, nëse ekzistojnë rrethanat e renditura më poshtë. Mbase nuk ka nevojë, por thjesht...

**Ermonela Felaj** – Mund të kemi një qëndrim të ministres së Drejtësisë, në momentin që ministri i Drejtësisë ndërhyr mbas një viti, si e realizon këtë gjë?

E dyta, se më duket nuk e keni të shprehur në ligj, a do të ketë një kohëzgjatje maksimale të shprehur në projekt, se sa mund të zgjasë ky regjim i posaçëm? 1-2 vjet? Sa herë do të ketë të drejtë ministri i Drejtësisë ta zgjasë këtë regjim të posaçëm? Kjo është lënë e hapur.

**Etilda Gjonaj** - Edhe pyetja që zonja Gjebrea bëri, është një çështje që ne e kemi diskutuar dhe ka pasur një diskutim të gjatë. Është vendosur që ministri i Drejtësisë investohet nëse është bërë një kërkesë nga një i dënuar ose i paraburgosur. Pra, vetë ministri i Drejtësisë nuk mund të marrë vendim për një regjim të posaçëm dhe të thotë: po, tani do t'i rishikoj një herë në vit mbi atë afat që është parashikuar nga gjykatat edhe për një kategori individësh, që qëndrojnë në një institucion penitenciar, por nuk kanë një dënim. Është vendosur që gjithmonë që të bëhet me kërkesë të të dënuarit ose të të paraburgosurit. Në bazë të kësaj ministri i Drejtësisë shikon mbas 1 viti nëse janë kushtet për zgjatjen e këtij afati ose jo, mbasi ka plotësuar dhe ka marrë informacionin nga të gjitha strukturat, si prokurori, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe ministri i Brendshëm duke përfshirë të gjitha strukturat e tij.

Për sa i përket afatit maksimal, pra sa herë duhet ta rishikojë ministri këtë, ne nuk kemi vendosur një *dead line* apo një afat fundor deri kur, pasi kjo është e vazhdueshme. Kjo është arsyeja pse në propozimin që është bërë, nuk gjen një parashikim konkret, duke e lënë vazhduese.

**Ermonela Felaj** – Po, zonja Elona.

**Elona Gjebrea** – Atëherë, mendoj që paragrafi i parë “Ministri i Drejtësisë vendos zgjatjen” duhet të vendoset pas germës “e” dhe pastaj të vazhdojë sqarimi që me kërkesë të të dënuarit, pas një periudhe, ministri mund ta rivlerësojë, sepse nuk ka kuptim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kuptova.

Domethënë, paragrafi “Ministri i Drejtësisë vendos zgjatjen e afatit”, të vendoset përpara paragrafit “me kërkesë të të dënuarit”. Ky është sugjerimi im. Sqarohet përpara që

ministri i Drejtësisë vlerëson nëse janë kushtet dhe pastaj thuhet që ministri vendos zgjatjen e afatit. Ndoshta e kam gabim, por ky është mendimi im. Është thjesht ndryshim paragrafësh, por drejtoritë përkatëse e dinë më mirë logjikën.

**Ermonela Felaj** – Në diskutimin që do t'i bëjmë germë për germë ne do ta reflektojmë edhe një herë ndërhyrjen e zonjës Gjebrea.

Po, zonja Dhima.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre për prezantimin!

Dihet që lufta kundër krimit të organizuar është një nga prioritetet e qeverisë dhe një nga detyrat e Bashkimit Europian.

Cilët janë mekanizmat që ju do të përdorni për të parandaluar kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo edhe organizatat e tjera aleate, konfliktet e mundshme me elementë të organizatave kundërshtarë dhe ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin të njëjtës organizatë ose organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë?

Faleminderit!

**Etilda Gjonaj** – Është regjimi i posaçëm me të gjitha masat që do të merren, si dhe masat në drejtimin paralel, që unë përmenda, për sa i përket disa masave shtesë për rritjen e sigurisë, si salla operationale dhe disa elemente të tjera që do të merren në këto regjime, të cilat do të bëjnë të mundur që këto që ju përmendët të mos jenë problem në të ardhmen. Të mos shikohet më si një problem i kushteve apo i ligjit, por më pas të shikohet dhe të vihen përgjegjësitë për ata që e zbatojnë këtë parashikim ligjor.

**Antoneta Dhima** - A keni ju burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për t'i përballuar këto?

**Etilda Gjonaj** - E shpjgoi pak drejtori këtë gjë. Burimet financiare dhe njerëzore asnjëherë nuk janë të mjaftueshme, sidomos kur flasim për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku për një kohë më shumë se 28 vjet janë bërë investime minimale. Infrastruktura në shumicën e institucioneve sot është e amortizuar, prandaj ndërhyrjet me investime financiare apo edhe burime njerëzore janë të domosdoshme. Megjithatë, janë marrë disa masa për të shtuar zbatimin e propozimit 13, paragrafi i parë, për sallën operationale dhe rritjen e masave të sigurisë duke bërë një shtesë të numrit të burimeve njerëzore, të cilët më pas do të kalojnë nëpër trajnime.

Para një muaji Këshilli i Ministrave vendosi të kalojë një fond rreth 960 milionë lekë të vjetra për të bërë këto ndërhyrje për rritjen e elementeve të sigurisë, që ishte salla operacionale dhe elementet e tjera, kjo për t'i dhënë një hov ndryshe investimeve në rritjen e elementeve të sigurisë.

Ky projekt ka filluar dhe po zbatohet bashkë me AKSHI-n, meqenëse janë ata të cilët po kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të zbatimit. Më pas, në momentin që ky parashikim në këtë projektligj do të pranohet dhe nëse do të miratohet nga Kuvendi, do të shkojmë paralelisht me zbatimin e këtyre projekteve që kemi nisur.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Në fakt, nuk mendoj që propozimet që bëme për masat për regjimin e posaçëm kërkojnë mbështetje financiare. Lejimi i një takimi familjar një herë në muaj nuk kërkon mbështetje financiare, thjesht e përjashton nga numri maksimal i takimeve ose nga takimet që kanë të drejtë të realizojnë të tjerët, të flasësh në telefon një herë në muaj është e njëjta gjë, të kufizosh rrethin e njerëzve që do të takojë është e njëjta gjë, të kufizosh orët e ajrimit është po ashtu një masë tjetër që nuk kërkon financim. E vetmja masë që indirekt kërkon financim është ajo që lidhet me ndalimin e përdorimit të sendeve me vlera monetare ose sendeve të tjera që, kuptohet, duke shfrytëzuar edhe mungesat e skanerëve nëpër burgje, mund të përfundojë në duart e të burgosurve të rrezikshëm.

**Etilda Gjonaj** – Shtesa në zëra financiarë ka të bëjë me elemente të sigurisë, si sistemi i kamerave. Nëse do të kemi një regjim të posaçëm për këta elementë kriminalë, do të kërkojnë disa elemente shtesë. të cilat, sot, për hir të së vërtetës, në institucionet penitenciare nuk janë në gjendje aq të mirë.

Duke pasur në konsideratë që edhe salla operacionale do të ketë një lidhje duke vazhduar procesin edhe me institucionet e tjera, kjo do të kërkojë, gjithashtu, burime shtesë, të cilat po mundohemi t'i menaxhojmë brenda zërave buxhetorë që ka Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

**Ermonela Felaj** – Besoj se është e drejtë ndërhyrja juaj, ndryshe ne do të detyroheshim t'i merrnim mendim Këshillit të Ministrave për faturën financiare.

Ka kolegë të tjerë që duan të sqarojnë nëpërmjet pyetjeve momente të tjera të këtij projekti?

Unë besoj që mund të kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.



Kush është dakord me votimin në parim të projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16. 04. 1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Ju faleminderit, kolegë!

Ndërkohë, meqenëse e hapëm këtë diskutim sot dhe meqenëse pati ndërhyrje në disa pika, duke pasur bashkëpunim edhe me stafin e Ministrisë së Drejtësisë, ju ftoj që të shfrytëzoni një periudhë të vogël kohore, deri në momentin që ky ligj do të planifikohet për në seancë plenare, për të riparë variantin që është propozuar nga EURALIUS-i dhe variantin që kemi përpara nga ministria, për të bërë edhe ne propozimet tona për Komisionin e Ligjeve.

Kështu që, në një moment të dytë do të njoftoheni për votimin e pikave të atij neni dhe në tërësi të tij.

Faleminderit, zonja Ministre, dhe gjithë stafit që ju shoqëron për prezencën dhe punë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**